

VENDIM
Nr.98, datë 6.2.2013

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË STANDARDEVE TË HARMONIZUARA SHQIPTARE, QË
KANË KARAKTER REFERUES PËR PREZUMIMIN E KONFORMITETIT PËR
PRODUKTET E NDËRTIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 34 të ligjit nr.10480, datë 17.11.2011 “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”, dhe të neneve 4, 7 e 25 të ligjit nr.9290, datë 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së Standardeve të Harmonizuara Shqiptare, që kanë karakter referues për prezumimin e konformitetit të produkteve të ndërtimit, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Standardet e Harmonizuara Shqiptare, të dhënat e të cilave janë përfshirë në listën e përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, shërbejnë si dokument referencë për prezumimin e konformitetit të produkteve të ndërtimit, bazuar në nenin 4 “Kërkesat e përgjithshme të sigurisë dhe prezumimi i sigurisë” të kreut II “Siguria e përgjithshme” të ligjit nr.10480, datë 17.11.2011 “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi nr.279, datë 18.4.2007 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së produkteve të ndërtimit, për të cilat kërkohet vlerësimi i detyruar i konformitetit”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha